Njoftim

Në zbatim të neneve 16 dhe 46 të ligjit nr. 59/2016 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", nenit 11 dhe 12, pika 1 të "*Rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë",* miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 162 datë 20.10.2020, si dhe nenit 15 dhe 26, të "*Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë",* miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se në mbledhjen e datës 26.10.2026, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën administrative për shqyrtimin dhe miratimin e "*Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike*".

Dokumenti për konsultim gjendet i publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, në adresën www.ere.gov.al, në seksionin Konsultime.

Ftohen të gjitha palët e interesuara të shprehin komentet dhe rekomandimet e tyre me shkrim brenda 20 (njëzet) ditëve pune (nga data 29.10.2026 deri më 26.11.2026) në adresën: Rruga "Irfan Tomini", Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë; ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.